



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT  
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE  
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Office of Minister

Kancelarija Ministra

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

NUMËR: MASHT [I] 2/2004

DATË: 26.01.2004

### LËNDA: Themelimi i Këshillit të Ekspertëve për Arsimin e Lartë

Në bazë të nenit 34 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë rregullon çështjen në vijim me anë të këtij udhëzimi administrative (në vazhdim **Udhëzimi**).

#### Neni 1

##### Qëllimi

**1.1.** Me anën e këtij **Udhëzimi** përcaktohen kushtet e themelimit të Këshillit të Ekspertëve të AL ( më tutje **KEAL**), përbërja, statusi, struktura organizative, detyrat e punës dhe përgjegjësitë e **KEAL**.

**1.2.** Mbështetja profesionale e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (në vazhdim **MASHT**) .

#### Neni 2

##### Kushtet e themelimit të **KEAL**

Në kohen e thellimit të reformave në Arsimin e Lartë ( në vazhdim **AL**) dhe problemet me të cilat po përballlet ai në këtë drejtim, **MASHT** themelon **KEAL** për mbështetje të gjithëanëshme të **AL**.

#### Neni 3

##### Përbërja e **KEAL**

**3.1.** **KEAL** përbëhet prej ekspertëve vendorë, njohës të mirë të zhvillimeve arsimore, shkencore dhe organizative të **AL** dhe nga konsulentë ndërkombëtarë.

**3.2.** Numri i ekspertëve vendorë me të drejta të plota në **KEAL** është 9 deri 11, ndërsa numri i konsulantëve ndërkombëtarë është 1 deri në 3 dhe nga **MASHT** 1 deri 2 zyrtar.

**3.3.** Ekspertët vendorë dhe konsulantët ndërkombëtarë emrohen nga Ministri i **MASHT** me një vendim të vecant për një kohë fillestare prej 6 muajsh me mundësi të vazhdimit për aq kohë sa **MASHT** konsideron se puna e ekspertëve të **KEAL** është e nevojshme, në përputhje me qëllimin e themelimit.

**3.4.** Puna e ekspertëve dhe e konsulantëve do të fillojë pas nënshkrimit të një kontrate pune ndërmjet të **MASHT** dhe ekspertit apo konsulantit vec e vec në të cilën përshkruhen detyrat e punës dhe lartësia e kompenzimit material për kohën e angazhimit në **KEAL**.

#### **Neni 4** **Aktiviteti**

**KEAL** aktivitetin e vet e zhvillon nëpërmes mbledhjeve të zakonshme, seminareve dhe formave të tjera që i konsideron të përshtatshme.

#### **Neni 5** **Statusi i KEAL**

Puna e **KEAL** është plotësisht e pavarur dhe në përputhje me mandatin që kanë anëtarët e tij dhe përgjegjësive të përcaktuara me këtë udhëzim administrative.

#### **Neni 6** **Struktura organizative**

**6.1.** **KEAL** ka kryesuesin I cili emrohet nga Ministri i **MASHT**, i cili e udhëheq dhe e kordinon punën e gjithëmbarshme të **KEAL**.

**6.2.** **KEAL** e ka edhe sekretarin ekzekutiv që zgjedhet nga radhët e **KEAL** dhe i cili i udhëheq të gjitha punët administrative të **KEAL**.

**6.3.** Anëtarët tjerë të **KEAL** janë ekspertë dhe kordinator profesional të punëve të përcaktuara me këtë udhëzim administrativ.

**6.4.** **KEAL** mund të zgjerojë fushëveprimtarinë e vet kur kjo kërkohet nga **MASHT** me vendim të vacant.

#### **Neni 7** **Detyrat e punës**

**7.1.** **KEAL** kryen detyra dhe punë në përputhje me qëllimin e themelimit të tij, si:

- Të hartojë planin e veprimit të **KEAL**;
- Të hartojë planin strategjik të zhvillimit **AL**;
- Të ndihmoj procesin e themelimit të **AAK**;
- Në procesin e realizimit të ligjshmërisë, **KEAL** ndihmonë **MASHT** dhe Institucionet e **AL** në përpilimin dhe rishikimin e statuteve dhe akteve të tjera nënligjore në përputhje me ligjin dhe strategjinë e zhvillimit të **AL**;

- Të ndihmojë MASHT në organizimin e konferencave dhe ngjarjeve tjera që kanë për qëllim zhvillimin e AL.
- Të informojë,raportoj së paku njëherë në muaj për punën e KEAL dhe këshilloj Ministrin e MASHT për zhvillimet në AL.

**7.2.** KEAL aktivitetin e vetë e zhvillon nëpërmes të mbledhjeve të zakonshme, seminareve, punëtorive dhe formave tjera që i konsideron të përshtatshme.

**7.3.** Konsulentët ndërkombëtarë marrin pjesë në takimet e KEAL, sjellin përvojën e vendeve të ndryshme Evropiane e botërore për arsimin e lartë, diskutojnë, debatojnë, sygjerojnë dhe këshillojnë KEAL dhe anëtarët e tij për çështje profesionale, ligjore dhe organizative.

**7.4.** Konsulentët ndërkombëtarë nuk kanë të drejtë vote në procesin e marrjes së vendimeve nga KEAL.

**7.5.** Zyrtarët e emëruar nga MASHT do të sigurojnë hapësirën dhe infrastrukturën e nevojshme për punën e KEAL, përcjellin punën e KEAL, japin sygjerrime dhe këshilla në përputhje me ligjin dhe politikën e MASHT në raport me arsimin e lartë dhe informojnë ministrin dhe sekretarin e përhershëm për punën e KEAL.

**7.6.** Zyrtarët e MASHT nuk kanë të drejtë vote në punën e KEAL.

## **Neni 8**

### **Përgjegjësitë e KEAL**

**KEAL** është përgjegjës:

- të nxjerr vendime për punën e KEAL,
- të informojë, rekomandojë, këshillojë dhe propozojë ministrit për gjendjen dhe masat që duhet ndërmar MASHT dhe institucionet e AL në zhvillimin e reformave arsimore;
- të mbajë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për punën e KEAL dhe të raportoj ministrit për punën e KEAL.

## **Neni 9**

### **Hyrja në fuqi**

Ky **udhëzim** hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të Ministrit.

---

**Rexhep Osmani, Ministër**